



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**  
**INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR**

**LISTË VERIFIKIMI PËR SHËRBIMIN E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT**

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

**1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT**

1.	<b>Emri i Subjektit</b>	
2.	<b>Data e Fillimit të aktivitetit</b>	
3.	<b>Lloji i aktivitetit ekonomik</b>	
4.	<b>Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)</b>	
5.	<b>Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)</b>	
6.	<b>Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)</b>	
7.	<b>NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)</b>	
8.	<b>Tipi i Pronësisë</b>	<b>Tipi i Subjektit</b>

**LISTË VERIFIKIMI PËR SHËRBIMIN E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT**

Emri i Subjektit:

\_\_\_\_\_

Drejtues teknik:

\_\_\_\_\_

Specialiteti Mjekësor:

\_\_\_\_\_

Numri i përgjithshëm i personelit:

\_\_\_\_\_

Pajisje me burim rrezatimi:

\_\_\_\_\_

Në zbatim të ligjit nr. 9737 datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullore e ministrisë së shëndetësisë “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe

komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë” 2015, rregullore e ministrisë së shëndetësisë “Për zbatimin e skemës së hemovigilencës” 2015.

Nr	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Germa b, pika 1, neni 1, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron shërbimi i transfuzionit standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë së gjakut njerëzor dhe të përbërësve të tij?		
2	Pika 2, neni 8, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet përpara dhurimit, informimi dhe nënshkrimi i formularit standard nga dhuruesi?		
3	Pika 2, neni 8, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A nënshkruhet formulari standard edhe nga specialisti shëndetësor, që përgjigjet për marrjen e historisë shëndetësore të dhuruesit?		
4	Germa a, pika 3, neni 8, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Transfuzionit ruajtjen e sistemit të të dhënave, si dhe parandalimin e çdo lloj transferimi, dëmtimi apo ndryshimi të dosjeve të dhuruesve?		
5	Germa b, pika 3, neni 8, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Transfuzionit garantimin e të dhënave të dhuruesve në të gjitha hallkat e procesit të gjurmimit?		
6	Pika 1, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit promovimi i dhurimit vullnetar, të rregullt dhe falas të gjakut?		
7	Germa a, pika 2, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit përcaktimin e përshtatshmërisë së dhuruesve për dhurim?		
8	Germat b, c, d, pika 2, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe shpërndarja e gjakut dhe përbërësve të tij në përputhje me kriteret ligjore?		
9	Germa ç, pika 2, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit kontrolli i detyrueshëm laboratorik, për të plotësuar kriteret dhe standardet zyrtare të cilësisë dhe sigurisë për çdo njësi gjaku ose përbërësi të tij?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
10	Germa a, pika 3, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit ekzaminimi i pacientëve të planifikuar për transfuzion?		
11	Germa c, pika 3, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit mbështetja transfuzionale në shërbimet e urgjencës dhe të emergjencës?		
12	Germa e, pika 3, neni 11, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor në fushën e transfuzionit funksionimi si vëzhgues epidemiologjikë, në kuadër të sistemit të hemovigilencës?		
13	Germa a, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Gjakut mbështetje për programimin kombëtar të veprimtarive të shërbimeve të transfuzionit?		
14	Germa b, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Gjakut informacion për Ministrinë e Shëndetësisë për programin vjetor të vetëmjaftueshmërisë?		
15	Germa dh, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryen Qendra Kombëtare e Gjakut realizimin e funksionit bashkërendues për sistemin informativ në shërbimin e transfuzionit?		
16	Germa f, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryen Qendra Kombëtare e Gjakut hartimin dhe zbatimin e programit të kualifikimit të personelit të mesëm të Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit?		
17	Germa gj, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryen Qendra Kombëtare e Gjakut hartimin dhe zbatimin e skemës së hemovigilencës, sipas urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë?		
18	Germa h, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A kryen Qendra Kombëtare e Gjakut kontrollin e metodave diagnostike të përdorura për vlerësimin e cilësisë, sigurisë, efikasitetit dhe përdorueshmërisë së procedurave të zbatuara në këtë fushë?		
19	Germa i, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Gjakut kujdesin për regjistrin kombëtar të gjakut, për sa u përket aspekteve tekniko-organizative të tij?		
20	Germa j, pika 2, neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A siguron Qendra Kombëtare e Gjakut mbështetjen e organizimit të kontrollit të jashtëm të cilësisë në fushën e transfuzionit?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
21	Pika 1, neni 20, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007.	A është marrë miratim nga Ministri i Shëndetësisë në rastet e importimit dhe eksportimit të gjakut ose i produkteve të tij për përdorim terapeutik, profilaktik e diagnostik?		
22	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 2, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	Forma e organizimit të shërbimit të transfuzionit të gjakut në spitalet jo publike dhe publike është Shërbim 24 orë?		
23	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 2, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	Forma e organizimit të shërbimit të transfuzionit të gjakut në spitalet jo publike dhe publike është Shërbim 8 orë?		
24	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 1, neni 3, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A bëhet përcaktimi i nevojës për transfuzion nga mjeku kurues ?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
25	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007, Pika 1, neni 3, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A ka marrë parasysh mjeku kurues përpara se të bëjë kërkesën për gjak ose komponentë të tij sa më poshtë: a. Të përdorë të gjitha mundësitë për trajtim alternativ (pa transfuzion) përpara se të vendos për terapinë transfuzive. b. Të siguroj përdorimin e transfuzionit autolog për të sëmur të përshtatshëm që do t'i nënshtrohen ndërhyrjeve të planifikuara. c. Të siguroj përdorimin e zëvendësimeve familjare të gjakut në të gjitha rastet e planifikuara dhe në urgjencat nëse është e mundur ?		
26	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Neni 4, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A bëhet fletë–kërkesa sipas dokumenteve standarde te përcaktuara në këtë Rregullore: A- “Formular standard analizash” për përcaktimin e grupit të gjakut apo edhe testimet e tjera dhe B-“ Formular kërkesë për komponentët e gjakut”?		
27	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 5, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A plotëson mjeku kurues me saktësi fletë–kërkesën, e cila duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur prej tij?		
28	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 3, neni 6, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A kontrollon personeli i bankës së gjakut në spitalin publik në çdo rast nëse të dhënat e fletë–kërkesës përputhen me ato të mostrës së gjakut të pacientit?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
29	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 4, neni 6, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A ka të shënuara mostra e gjakut të pacientit nga spitali jo publik mbi tub përveç të dhënave të përcaktuara edhe grupin e gjakut të përcaktuar nga laboratorit i spitalit jo publik?		
30	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Germat a, b, c, ç, pika 1, neni 8, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A regjistrohen rezultatet e testimeve laboratorike në: -Fletën ditore të punës. -Në regjistrin e “ Përcaktimit të grupeve të gjakut”. -Në kartelën personale të pacientit. -Në pjesën përkatëse të flete–kërkesës, e cila më pas vendoset në kartelën klinike personale të pacientit?		
31	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 1, neni 9, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A tërhiqen gjaku ose komponentët e tij në bankën e gjakut vetëm nga personeli mjekësor (mjek ose infermier), mundësisht një person i ngarkuar me këtë detyrë për çdo klinikë në spitalet publike dhe jo publike?		
32	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Neni 9, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A kryhet procedura e tërheqjes së gjakut në bankën e gjakut sipas kritereve të përcaktuara në këtë rregullore?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
33	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 1, neni 10, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A bëhet transporti i njësive të gjakut dhe komponentëve nga bankat e gjakut në klinikat e spitalit publik ose spitalet jo publike me termobokse me temperaturë të kontrolluar?		
34	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 11, neni 14, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A regjistrohet çdo njësi gjaku ose komponentë të tij të tërhequra në bankën e gjakut në regjistrin përkatës të gjakut, në klinikë (pavijon, në repartin e terapisë intensive apo sallën e operacionit)?		
35	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 1, pika 2, neni 13, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A bëhet nga mjeku kurues dokumentimi i transfuzionit në kartelën e pacientit?		
36	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 1, neni 17, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A plotësohet në çdo bankë gjaku regjistri i shpërndarjes së gjakut dhe komponentëve të tij duke shënuar të gjitha njësitë e disponueshme?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
37	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 17, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A plotësohet në çdo bankë gjaku proces – verbali i dorëzimit të njësive të gjakut në ndërresat e ndryshme?		
38	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 6, pika 7, neni 19, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A ka spitali, në përputhje me kushtet konkrete, rregulloren e tij të brendshme të punës në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje, dhe a funksionon një sistem kontrolli në lidhje me përdorimin e përshtatshëm të gjakut dhe komponentëve të tij?		
39	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 5, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A përcaktohet dhe identifikohet nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit dhe Bankat e Gjakut në një sistem të veçantë (INLOG Server) dhe në mënyrë unike çdo dhurues, çdo njësi gjaku të mbledhur dhe çdo komponent gjaku të përgatitur, cilido qoftë qëllimi i përdorimit dhe klinika ku është shpërndarë ky komponent i caktuar gjaku?		
40	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Germa a, pika 3, neni 5, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A dokumentojnë strukturat spitalore publike dhe jo publike që përdorin gjak dhe komponentë të tij: -Emrin e llojin e produktit të transfuzuar. -Të dhënat e qeses që do të transfuzohet si: numrin e njësisë, kodin e dhuruesit, (grupin ABO, RhD, inicialet e saj). -Datën e mbledhjes dhe datën e kadencës së njësisë. -Datën e marrjes së transfuzionit. -Emrin e pacientit. -Numrin e kartelës së pacientit?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
41	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Germa b, pika 3, neni 5, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A dokumentojnë strukturat spitalore publike dhe jo publike që përdorin gjak dhe komponentë të tij destinacionin final të çdo njësie të tërhequr në bankën e gjakut, nëse ajo është : -Transfuzuar tek pacienti. -Kthyer në bankën e gjakut përkatëse. -Shkatërruar ?		
42	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 4, neni 5, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A përcakton banka e gjakut një identifikues unik (barkod të vetin) që i mundëson asaj të lidhet saktësisht me çdo njësi gjaku që ajo ka mbledhur dhe çdo komponent gjaku që ka përgatitur?		
43	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 2, neni 8, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A njoftojnë menjëherë strukturat spitalore publike dhe jo publike, që përdorin gjak ose produkte të tij bankën e gjakut, në momentin e konstatimit për reaksione të padëshiruara të vërejtura tek marrësi, gjatë apo mbas transfuzionit, të cilat mund të jenë të lidhura me cilësinë dhe sigurinë e gjakut dhe komponentëve të tij, apo me ndonjë gabim të mundshëm njerëzor?		
44	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 3, neni 8, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A bëhet njoftimi i reaksioneve të padëshiruara nga transfuzioni i gjakut ose komponentëve të tij në bankën e gjakut nga mjeku që kryhen transfuzionin, sipas formularit të Raportimit mbi Reaksionet nga Transfuzioni?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
45	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 4, neni 8, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A njofton menjëherë banka e gjakut në spital, pas marrjes së raportimit nga strukturat spitalore përkatëse për reaksione të padëshiruara nga transfuzioni, Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut?		
46	Neni 15, ligji nr. 9739, datë 21.5.2007; Pika 5, neni 8, rregullore “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”, 2015.	A ka plotësuar QKTGJ mbi bazë vjetore Formularin e Raportimit, sipas aneksit II, pjesa D dhe a e ka dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë, në Drejtorinë e Administrimit Spitalor?		

**INSPEKTORËT**